



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.374/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj- anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Kreshnik Sopi, kandidat për kuvend komunal në komunën e Komunën e Prishtinës nga radhët e subjektit politik “Lidhja për Prishtinën”, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura në 12 Tetor 2025, me datë 05.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.374/2025, e datës 04.11.2025, e parashtruar nga Kreshnik Sopi, kandidat për kuvend komunal në Komunën e Prishtinës nga radhët e subjektit politik “Lidhja për Prishtinën”, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura në 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 04.11.2025, ka pranuar ankesën ZL.Anr.374/2025, nga Kreshnik Sopi, kandidat për kuvend komunal në Komunën e Prishtinës nga subjekti politik “Lidhja për Prishtinën”, paraqitur ndaj KQZ-së, me të cilën konteston se mënyrën se si është aplikuar kuota gjinore, e cila, në vend që të garantojë përfshirje minimale të gjinisë së kundërt, është zbatuar në mënyrë mekanike duke tejkaluar kufirin e arsyeshem dhe duke çuar në përjashtimin e një kandidati që ka fituar më shumë vota nga qytetarët. Sipas parashtruesit të ankesës, një zbatim i tillë bie ndesh me nenet 3, 7, 22, 24 dhe 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që garantojnë parimin e barazisë para ligjit, barazinë ligjore, të drejtën për pjesëmarrje në zgjedhje dhe përfaqësimin të drejtë në organet publike. Tutje , ankuesi thekson se në zgjedhjet për assemble komunale të Prishtinës, subjekti politik “Lidhja për Prishtinën” ka fituar 4 ulëse. Ankuesi, Kreshnik Sopi, renditet i treti në listën e kandidatëve sipas numrit të votave të fituara, pas dy kandidatëve të tjerë. Në bazë të kuotës gjinore 30%, në vendin e tretë është përfshirë një kandidate femër, çka është plotësisht në përputhje me ligjin saktësisht nenin 8, par.8.4 duke garantuar përfaqësim minimal të gjinisë së kundërt. Megjithatë, sipas parashtruesit të ankesës në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me parimet e ligjit, në vendin e katërt është përfshirë një tjetër kandidate femër, duke e përjashtuar ankuesin dhe duke e çuar përfaqësimin e grave në

mbi 50% të ulëseve të fituara nga subjekti, gjë që përbën tejkalim të kuotës ligjore. Ankuesi thekson se përkundër faktit se ka marrë votat e mjaftueshme dhe është përzgjedhur me votë të qytetarëve që të përfaqësoj, pretendon se padrejtësisht është larguar nga përfaqësimi dy herë, tutje ankuesi thekson se përjashtimi i tij nga lista përfundimtare nuk është rezultat i mungesës së votave apo i renditjes së tij, por i interpretimit të gabuar të kuotës gjinore, tejkaluar mbi 50% kuota është përdorur në menyrë arbitrare, duke cenuar të drejtën e ankuesit për përfaqësim të drejtë dhe të barabartë dhe për më tepër procesi i numërimit ka qenë i shoqëruar me një sërë parregullsish që janë konstatuar edhe nga vëzhgues të pavarur në QNR, ku është vërejtur mospërputhje mes numrit të votave preferenciale dhe rezultatit përfundimtar, çka shton dyshimin për cenim të vullnetit të zgjedhësve. Andaj, parashtuesi i ankesës duke u bazuar në nenin 8 par.8.4, neni 105 dhe 118 i LZP, në nenin 13 të Rregullores Zgjedhore nr.01/2025 të PZAP-it si dhe në parimet e jurisprudencës vendore dhe ndërkombëtare për barazinë zgjedhore, kërkon nga PZAP të urdhërojë KQZ që të korigjojë listën përfundimtare të Asamblesë Komunale të Prishtinës, duke përfshirë Kreshnik Sopin si përfaqësues ligjrisht të zgjedhur në bazë të renditjes së votave. Në mënyrë shtesë, ankuesi kërkon që Gjykata të urdhërojë rinumërimin dhe rivlerësimin e votave preferenciale për kandidatët e listës përkatëse, për të garantuar që përfaqësimi në kuvend komunal të Prishtinës të jetë në përputhje me ligjin, me barazinë e votës dhe me parimin e demokracisë përfaqësuese.

Parashtuesi i ankesës ka bashkangjitur në ankesë, publikimin e rezultateve nga KQZ për subjekte politike.

Në përgjigjen në ankesë, KQZ-ja jep sqarimet/përgjigje sipas dispozitave ligjore, përkatësisht nenit 8, par.4, në ndërlidhje me par.3 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, përcaktohet qartazi që kuota gjinore prej 30% zbatohet brenda listave të subjekteve politike që kanë fituar mandate, me përjashtim të listave në kuadër të së cilave janë fituar dy mandate(ku ndarja behët në proporcion 50-50%) apo një mandat i vetëm (ku vendi i ndahet kandidatit apo kandidatës më të votuar). Të vepruarit ndryshe, sipas kërkesës së palës ankuese, do të cenonte parimin e barazisë para ligjit, në atë menyrë që po që se kuota për institucionin në terësi do të përmbushej vetëm nga një apo më shumë subjekte politike, të tjerat do të përjashtoheshin nga obligimi për të pasur të paktën 30% nga kandidatët e gjinisë së nënpërfaqësuar që fitojnë vende në kuvendet komunale. Poashtu, legjislacioni zgjedhor në zgjedhjet lokale nuk përcakton kuotën për kuvendin komunal si tërësi por për listat e subjekteve, si vijon:

Në kuptim të nenit 8 par.3 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale, vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas par.2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik. Neni 8.4 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në par.3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%.

Një përcaktim i tillë është rikonfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, përmes Aktgjykimit në rastet KI45/20 dhe KI46/20 në të cilin aktgjykim ndër të tjera thuhet se :

“131... Rrjedhimisht, parimet kushtetuese të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit mbeten të një rëndësie vendimtare dhe se çështja e kuotave gjinore, për arsye historike dhe kulturore, si dhe të mënjanimi të pabarazive faktike në mes grave dhe burrave, është në pajtueshmëri me frymën e sistemit normativ kushtetues.

“164...Gjykata potencoi se, ratio legis i LZP, në kontekst të përfaqësimit gjinor në Kuvend, konsiston në atë që siguron-në çdo rrethanë-përfaqësim prej të paktën 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar ose gjinisë pakicë. Mirëpo qartazi, 30% paraqet vetëm kufirin 40 minimal të përfaqësimit të njëres gjini. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se, në momentin që sigurohet përfaqësimi minimal prej 30% për gjininë e nënparfaqësuar, të gjitha zëvendesimet e ardhshme duhet të behën në bazë të renditjes të kandidatëve për deputetë që e përcakton rezultati zgjedhor. Mbi këtë bazë, kuota gjinore zbatohet vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin vendosur, pra, për të siguruar përfaqësimin e detyrueshëm minimal të gjinisë pakicë në kuotën prej 30%.

Në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, lidhur me formulën për ndarjen e ulësve të Kuvendit të Komunës, si dhe numri më i vogël i kandidatëve nga gjinia e kundërt nëse numri i kandidatëve që kanë fituar mandatë është dy (2) atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë një (1), pra duhet të jetë një mashkull dhe një femër. Gjithashtu edhe tek rastet kur subjekti politik ka fituar katër (4) ulëse, atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë 2, pra duhet të jenë dy meshkuj dhe dy femra, sepse po që se do të jetë ndryshe atëherë nuk do të arrihet përfaqësimi minimal në kuotën prej 30% i gjinisë së kundërt. KQZ ka bashkangjitur në përgjigje: Rezultatet për kuvendin komunal në Prishtinë, subjekti politik të Lidhja për Prishtinën.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se bazuar në pretendimet ankimore të ankuesit gjeti se ankesa është e pabazuar sepse respektimi i kuotës nënkupton përfaqësim minimum 30% të gjinisë së kundërt dhe po që se përfaqësimi është 50% nga kjo konsatohet se nuk është në kundërshtim me ligjin, duke u bazuar në dispozitën e nenit 8 par.3 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas par.2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik. Në Nenin 8 par.4 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, në mënyrë decitive thuhet se :*“Nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në par.3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%”.*

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pabazuara, pasi që kandidatët e zgjedhur nga Lista “Lidhja për Prishtinën” janë zgjedhur duke u bazuar në votat e marra në Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 12 Tetor 2025 në Republikën e Kosovës, dhe njëherit kandidatët nga Lista “Lidhja për Prishtinën” janë zgjedhur duke u

bazuar në nenin 8 par.4 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale për të arritur përfaqësimin minimum të 30 % të gjinisë së kundërt.

Njëherit për raste të njëjta, ka praktikë edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila për raste të njëjta ka vendosur me Aktgjykimet në rastet KI45/20 dhe KI46/20.

Andaj Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruar në ankesën e parashtruar, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.374/2025 më datën 05.11.2025

Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.108/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitia Ymeri dhe Nenad Lazic, anëtar të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së Kreshnik Sopi, kandidat për kuvend komunal në Komunën e Prishtinës nga radhët e subjektit politik "Lidhja për Prishtinën", për shkak të parregullsive në shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura në 12 Tetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.374/2025, të datës 05.11.2025, në seancën e mbajtur më datë 10.11.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Kreshnik Sopi, kandidat për kuvend komunal në Komunën e Prishtinës nga radhët e subjektit politik "Lidhja për Prishtinën", e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.374/2025, të datës 05.11.2025.

A r s y e t i m i

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin ZL.Anr.374/2025, të datës 05.11.2025, ka vendosur: "REFUZOHE E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.374/2025, e datës 04.11.2025, e parashtruar nga Kreshnik Sopi, kandidat për kuvend komunal në Komunën e Prishtinës nga radhët e subjektit politik "Lidhja për Prishtinën", të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura në 12 Tetor 2025".

Kundër vendimit të lartpërmendur, Kreshnik Sopi, kandidat për kuvend komunal në Komunën e Prishtinës nga radhët e subjektit politik "Lidhja për Prishtinën", përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke pretenduar se KQZ ka transformuar një masë afirmative në diskriminim të kundërt, duke dëmtuar barazinë e votës së qytetarëve që kanë votuar për ankuesin, duke propozuar që Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës të pranojë si të bazuar ankesën, të anulojë vendimin e PZAP, ZL.Anr.374/2025, të datës 05.11.2025, të urdhërojë KQZ-në që të korrigjoj shpërndarjen përfundimtare të mandateve të subjektit politik "Lidhja për Prishtinën", për Kuvendin Komunal të Prishtinës, duke përfshirë kandidatin Kreshnik Sopi në bazë të



numrit real të votave preferenciale dhe të konstatoj se zbatimi mekanik i kuotës gjinore përtej 50% është në kundërshtim me nenin 45 të Kushtetutës, nenin 3 të Protokollit Nr.1 të KEDNJ-së dhe parimin e proporcionalitetit zgjedhor.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të Kreshnik Sopi, kandidat për kuvend komunal në Komunën e Prishtinës nga radhët e subjektit politik "Lidhja për Prishtinën", kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e Kreshnik Sopi, kandidat për kuvend komunal në Komunën e Prishtinës nga radhët e subjektit politik "Lidhja për Prishtinën" të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi i ankimuar i PZAP-së.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se PZAP-i më datë 04.11.2025, ka pranuar ankesën ZL.Anr.374/2025, nga Kreshnik Sopi, kandidat për kuvend komunal në Komunën e Prishtinës nga subjekti politik "Lidhja për Prishtinën", paraqitur ndaj KQZ-së, me të cilën konteston se mënyrën se si është aplikuar kuota gjinore, e cila, në vend që të garantojë përfshirje minimale të gjinisë së kundërt, është zbatuar në mënyrë mekanike duke tejkaluar kufirin e arsyeshëm dhe duke çuar në përjashtimin e një kandidati që ka fituar më shumë vota nga qytetarët. Sipas parashtruesit të ankesës, një zbatim i tillë bie ndesh me nenet 3, 7, 22, 24 dhe 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që garantojnë parimin e barazisë para ligjit, barazinë ligjore, të drejtën për pjesëmarrje në zgjedhje dhe përfaqësimin të drejtë në organet publike. Tutje, ankuesi thekson se në zgjedhjet për assemble komunale të Prishtinës, subjekti politik "Lidhja për Prishtinën" ka fituar 4 ulëse. Ankuesi, Kreshnik Sopi, renditet i treti në listën e kandidatëve sipas numrit të votave të fituara, pas dy kandidatëve të tjerë. Në bazë të kuotës gjinore 30%, në vendin e tretë është përfshirë një kandidate femër, çka është plotësisht në përputhje me ligjin saktësisht nenin 8, par. 8.4 duke garantuar përfaqësim minimal të gjinisë së kundërt. Megjithatë, sipas parashtruesit të ankesës në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me parimet e ligjit, në vendin e katërt është përfshirë një tjetër kandidate femër, duke e përjashtuar ankuesin dhe duke e çuar përfaqësimin e grave në mbi 50% të ulëseve të fituara nga subjekti, gjë që përbën tejkalim të kuotës ligjore. Ankuesi thekson se përkundër faktit se ka marrë votat e mjaftueshme dhe është përzgjedhur me votë të qytetarëve që të përfaqësoj, pretendon se padrejtësisht është larguar nga përfaqësimi dy herë, tutje ankuesi thekson se përjashtimi i tij nga lista përfundimtare nuk është rezultat i mungesës së votave apo i renditjes së tij, por i interpretimit të gabuar të kuotës gjinore, tejkaluar mbi 50% kuota është përdorur në mënyrë arbitrare, duke cenuar të drejtën e ankuesit për përfaqësim të drejtë dhe të barabartë dhe për më tepër procesi i numërimit ka qenë i shoqëruar me një sërë parregullsish që janë konstatuar edhe nga vëzhgues të pavarur në QNR, ku është vërejtur mospërputhje mes numrit të votave preferenciale dhe rezultatit përfundimtar, çka shton dyshimin për cenim të vullnetit të zgjedhësve. Andaj, parashtruesi i ankesës duke u bazuar në nenin 8 par. 8.4, nenin 105 dhe 118 i LZP, në nenin 13 të Rregullores Zgjedhore nr.01/2025 të PZAP-it si dhe në parimet e jurisprudencës vendore dhe ndërkombëtare për barazinë zgjedhore, ka kërkuar nga PZAP të



urdhërojë KQZ që të korrigjojë listën përfundimtare të Asamblesë Komunalë të Prishtinës, duke përfshirë Kreshnik Sopin si përfaqësues ligjërësht të zgjedhur në bazë të renditjes së votave. Në mënyrë shtesë, ankuesi kërkon që Gjykata të urdhërojë rinumërimin dhe rivlerësimin e votave preferenciale për kandidatët e listës përkatëse, për të garantuar që përfaqësimi në kuvend komunal të Prishtinës të jetë në përputhje me ligjin, me barazinë e votës dhe me parimin e demokracisë përfaqësuese. Parashtruesi i ankesës po ashtu i ka bashkangjitur ankesës publikimin e rezultateve nga KQZ për subjekte politike.

Në përgjigjen në ankesë, KQZ-ja ka dhënë sqarimet/përgjigje sipas dispozitave ligjore, përkatësisht nenit 8, paragraf 4, në ndërlidhje me paragraf 3 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, përcaktohet qartazi që kuota gjinore prej 30% zbatohet brenda listave të subjekteve politike që kanë fituar mandate, me përjashtim të listave në kuadër të së cilave janë fituar dy mandate (ku ndarja bëhet në proporcion 50-50%) apo një mandat i vetëm (ku vendi i ndahet kandidatit apo kandidatës më të votuar). Të vepruarit ndryshe, sipas kërkesës së palës ankuese, do të cenonte parimin e barazisë para ligjit, në atë mënyrë që po që se kuota për institucionin në tërësi do të përmbushej vetëm nga një apo më shumë subjekte politike, të tjerat do të përjashtoheshin nga obligimi për të pasur të paktën 30% nga kandidatët e gjinisë së nën përfaqësuar që fitojnë vende në kuvendet komunale. Po ashtu, legjislacioni zgjedhor në zgjedhjet lokale nuk përcakton kuotën për kuvendin komunal si tërësi por për listat e subjekteve, si vijon: Në kuptim të nenit 8 paragraf 3 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas paragraf 2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësishtë zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik. Neni 8.4 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në paragraf 3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%.

Një përcaktim i tillë është rikonfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, përmes Aktgjykimit në rastet KI45/20 dhe K146/20 në të cilin aktgjykim ndër të tjera thuhet se : "131... Rrjedhimisht, parimet kushtetuese të barazisë gjinore dhe mos diskriminimit mbeten të një rëndësie vendimtare dhe se çështja e kuotave gjinore, për arsye historike dhe kulturore, si dhe të mënjanimin të pabarazive faktike në mes grave dhe burrave, është në pajtueshmëri me frymën e sistemit normativ kushtetues. "164...Gjykata potencoi se, ratio legis i LZP, në kontekst të përfaqësimit gjinor në Kuvend, konsiston në atë që siguron-në çdo rrethanë-përfaqësim prej të paktën 30% të gjinisë së nën përfaqësuar ose gjinisë pakicë. Mirëpo qartazi, 30% paraqet vetëm kufirin 40 minimal të përfaqësimit të njërës gjini. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se, në momentin që sigurohet përfaqësimi minimal prej 30% për gjininë e nën përfaqësuar, të gjitha zëvendësimet e ardhshme duhet të bëhen në bazë të renditjes të kandidatëve për deputetë që e përcakton rezultati zgjedhor. Mbi këtë bazë, kuota gjinore zbatohet vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin vendosur, pra, për të siguruar përfaqësimin e detyrueshëm minimal të gjinisë pakicë në kuotën prej 30%.



Në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, lidhur me formulën për ndarjen e ulëseve të Kuvendit të Komunës, si dhe numri më i vogël i kandidatëve nga gjinia e kundërt nëse numri i kandidatëve që kanë fituar mandat është dy (2) atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë një (1), pra duhet të jetë një mashkull dhe një femër. Gjithashtu edhe tek rastet kur subjekti politik ka fituar katër (4) ulëse, atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë 2, pra duhet të jenë dy meshkuj dhe dy femra, sepse po që se do të jetë ndryshe atëherë nuk do të arrihet përfaqësimi minimal në kuotën prej 30% i gjinisë së kundërt. KQZ po ashtu ka bashkangjitur në përgjigje rezultatet për kuvendin komunal në Prishtinë, subjekti politik të Lidhja për Prishtinën.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se bazuar në pretendimet ankimore të ankuesit gjeti se ankesa është e pabazuar sepse respektimi i kuotës nënkupton përfaqësim minimum 30% të gjinisë së kundërt dhe po që se përfaqësimi është 50% nga kjo konsatohet se nuk është në kundërshtim me ligjin, duke u bazuar në dispozitën e nenit 8 paragraf 3 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas paragraf 2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik. Në nenin 8 paragraf 4 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, në mënyrë decisive thuhet se : "Nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në par.3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%".

Andaj, Paneli duke u bazuar në shkresat e lëndës, pretendimet e parashtruesit të ankesës i ka vlerësuar të pabazuara, pasi që kandidatët e zgjedhur nga Lista "Lidhja për Prishtinën" janë zgjedhur duke u bazuar në votat e marra në Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 12 Tetor 2025 në Republikën e Kosovës, dhe njëherit kandidatët nga Lista "Lidhja për Prishtinën" janë zgjedhur duke u bazuar në nenin 8 paragraf 4 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale për të arritur përfaqësimin minimum të 30% të gjinisë së kundërt. Njëherit për raste të njëjta, ka praktikë edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila për raste të njëjta ka vendosur me Aktgjykimet në rastet KI45/20 dhe KI46/20. Prandaj Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesën e parashtruar, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së. Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerësoj se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", andaj mbi këtë bazë edhe e ka refuzuar ankesën e ankuesit.



Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me refuzimin e ankesës së Kreshnik Sopi, kandidat për kuvend komunal në Komunën e Prishtinës nga radhët e subjektit politik "Lidhja për Prishtinën", për shkak të korigjimit të shpërndarjes së mandateve në listën e subjektit politik "Lidhja për Prishtinën", për Kuvendin Komunal të Prishtinës, për shkak të zbatimit të gabuar dhe joproporcional të kuotës gjinore. Kjo gjykatë vlerëson se vendimi i PZAP është i drejtë, i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet Lokale dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo rezulton se shkeljet e pretenduara për shkak të zbatimit të gabuar dhe joproporcional të kuotës gjinore vlerësohen të pabazuara.

Si rrjedhojë, objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të kandidatit për kuvend komunal në Komunën e Prishtinës nga radhët e subjektit politik "Lidhja për Prishtinën", Kreshnik Sopi, për shkak të zbatimit të gabuar dhe joproporcional të kuotës gjinore me rastin e shpërndarjes së mandateve në listën e subjektit politik "Lidhja për Prishtinën", për Kuvendin Komunal të Prishtinës, respektivisht korigjimin e shpërndarjes së mandateve për subjektin politik në fjalë, mirëpo këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara. Kjo për faktin se PZAP, me rastin e refuzimit të ankesës së ankuesit, si në vendimin e atakuar, me të drejtë ka vlerësuar se kandidatët e zgjedhur nga Lista "Lidhja për Prishtinën" janë zgjedhur duke u bazuar në votat e marra në Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 12 Tetor 2025 në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 8 paragraf 4 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale për të arritur përfaqësimin minimum të 30% të gjinisë së kundërt, me referencë në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastet KI45/20 dhe KI46/20.

Gjykata Supreme e Kosovës, e pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e PZAP-së edhe për zbatim të së drejtës materiale dhe atë duke u mbështetur në nenin 8 paragrafi 2, 3 dhe 4 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, ku përcaktohet se: "2 Të gjitha votat e fituara nga kandidatët që janë në listën e kandidatëve të çdo subjekti politik, numërohen ndaras. Listat me kandidatë rirenditen sipas mënyrës zbritëse në bazë të numrit të votave të fituara për secilin kandidat. 3. Vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas paragrafit 2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik. 4. Nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%".

Gjykata Supreme e Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave dhe nga dispozita e lartcekur erdhi në përfundim se ankesa e ankuesit është e pabazuar, ndërsa vendimi i PZAP-së është i drejtë dhe i ligjshëm. Në rastin konkret bazuar në dispozitën ligjore nga neni 8 paragrafi 2, 3 dhe 4 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, rezulton fakti se



lista finale e kandidatëve për asamble komunale duhet të përfshijë së paku tridhjetë përqind (30%) të kandidatëve të gjinisë më pak të përfaqësuar. Në rastet kur numri i përgjithshëm i kandidatëve në listë është i vogël dhe përqindja nuk jep një numër të plotë, kuota gjinore përcaktohet në numrin më të afërt më të madh, në mënyrë që të garantohet përfaqësimi minimal ligjor. Kështu, për një listë me katër (4) kandidatë, 30% përbën 1.2, që rezulton në dy (2) kandidatë nga gjinia më pak e përfaqësuar. Nëse vlerësojmë si tërësi nga gjithsej katër (4) kandidatë, përfaqësimi me vetëm një kandidate nga radhët e gjinisë femërore, përbën vetëm 25% të përfaqësimit, që nënkupton se është nën minimumin e paraparë prej 30 %, ashtu siç e përcaktojnë dispozitat ligjore të lartcekura. Gjykata Supreme e Kosovës, mori parasysh faktin se me përfaqësimin prej dy kandidatëve të gjinisë femërore në rastin konkret, përfaqësimi arrin në 50%, mirëpo kjo nuk bie ndesh me frymën e ligjit dhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, prandaj vendosi që ankesën e kandidatit ta refuzojë si të pabazuar.

Si rrjedhojë, përlllogaritja sikurse është aplikuar nga ana e KQZ-së dhe e konfirmuar nga ana e PZAP-it e tani edhe Gjykatës Supreme nuk cenon përcaktimin e vullnetit të votuesit, e as nuk bie në kundërshtim me praktikën e zgjedhjeve e as me praktikën e GJEDNJ-së, sikurse e pretendon pala ankuese.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se përfaqësimi gjinor nuk është vetëm një kërkesë formale në përbërjen e listës, por një detyrim që zbatohet edhe gjatë shpërndarjes së mandateve, në mënyrë që të sigurohet përfaqësim efektiv i të dy gjinive në institucionet e zgjedhura. Nëse shpërndarja e mandateve bazuar në votat e arritura do të çonte në përfaqësim nën 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar, ulësja i takon kandidatit/kandidates së asaj gjinie, edhe nëse kandidati tjetër ka më shumë vota, për shkak se mbizotëron parimi i përfaqësimit të barabartë gjinor, i paraparë me ligj dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Prandaj, pretendimi i kandidatit në ankesë se ulësja në Kuvendin Komunal i takon atij nuk qëndron ligjërisht, pasi një veprim i tillë do të shkelte dispozitat mbi kuotën gjinore dhe do të cenonte përfaqësimin minimal prej 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar në Kuvend Komunal.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtresit të ankesës, prandaj, pretendimet ankimore janë refuzuar si të pabazuara.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

A.A.nr.108/2025, datë 10.11.2025

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Rundori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-108/2025

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

PLAP - PRISATINE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjjet në vendin e ku është dëshitë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesë apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, fqut, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në dorën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (prbičeno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201____ në ora _____ cas.
dana _____ u _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes
Razlog odbijanja prijma

Nënshkrimi i dorëzuesit - polpis dostavljaca

(Të panevojshmeve bjert vizë - nepotrebné pečrati)

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKT67UKIM
10. 11. 2025

Numri i shtojcave:
broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrdjemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

11. 11. 2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Popis primaoca ili lica koje je
pismeno primilo u zameni)

V.SH 11. 03

Nënshkrimi i dorëzuesit - polpis dostavljaca

Në rast se marrësi është analibet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë
dorëzuesi, duke shkruar shkaktin pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet.
Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač.
napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.

Pr. 1208